

# ISM00D

## II Plus

### Udhëzues për përdorim












Ju lutemi lexoni dhe kuptoni me kujdes këtë manual  
përdorimi përpara se të përdorni pajisjen



## 1. VËSHTRIM

**ISMOD II Plus** është një pajisje me nxehtësi që nuk digjet, që vjen së bashku me një bateri litiumi të lidhur në të me kapacitet të madh, dy mbajtëse për pirje dhe një bazament të madh karikimi, që e bën të transferueshëm, të qëndrueshëm dhe komfort.


## 2. PËRMBAJTJA E PAKETËS

Kapaku mbrojtës		Kapaku mbrojtës	
ISMOD mbajtës		ISMOD Mbajtëse	
			
	Karikuesi		
			
			Udhëzues
			Kabllo karikimi
Shkopinj pastrimi			
			Pllakë pastrimi
			
			Furçë pastrimi

## 3. PARAMETRAT




Model	ISMOD II Plus
Fuqia që nevojitet	Kapaciteti i baterisë (2600 mah 3,7 v) Rryma maksimale e zbrazjes 2:A
Koha e karikimit	Koha e karikimit të Pauer bank 3 orë Koha e karikimit të mbajtësit ISMOD 6 minuta
Mënyra e karikimit	Porta për karikues USB Tip C i vendosur tek karikuesi 5v/2a
Temperatura e punës	5-40°C
Dimensionet e produktit	101mm*55mm*21mm
Pesha e produktit	115g


## 4. MANUALI I PUNËS



## 5. MANUAL PËRDORIMI

### PËRGATITJA






4. Prisni 15 sekonda derisa pajisja nuk fillon të vibrojë që të tregojë se procesi i ngrohjes së mëparshme të fishekut të duhanit të padjegshëm ka përfunduar.


5. Kur të ndriçojë drita blu pa ndërprerje mund të filloni ta përdorni. Kur përdorimi do të arrijë 12 thithje mbajtësi ISMOD




gjeneron vibracione të shpejta dhe drita blu fillon të pulsojë. Kur përdorimi do të arrijë 14 thithje ose kur do të përfundojë koha e ngrohjes mbajtësi ISMOD nuk punon më dhe do të fillojë të gjenerojë vibrimin final.



6. Tërhiqeni kapakun mbrojtës nga lart bashkë me fishekun e duhanit të padjegshëm pas përfundimit.



7. Hiqeni fishekun e duhanit të padjegshëm nga kapaku mbrojtës



## VËREJTJE:

**Kur do ta hiqni kapakun mbrojtës pas përdorimit, kushtojini vëmendje shenjës paralajmëruese të izolimit të brendshëm të ISMOD mbajtësit. Kur ta vendosni sërish kapakun kujdesuni për pozicionin që të mos dëmtoni mbajtësin ISMOD.**

## NDËRPRERJA E PËRDORIMIT

1. Nëse doni të ndërprisni pajisjen përpara se ajo të ndërpritet vetë shtypni dhe mbajeni butonin e kontrollit 3 sekonda, mbajtësi ISMOD nuk do të punojë dhe do të kalojë në gjendje të fikur, ndërsa drita e indikatorit do të gjenerojë lajmërim me vibrime.
2. Në kushte normale të përdorimit pas përfundimit të përdorimit ,mbajtësi ISMOD gjeneron paralajmërim me vibrim ndërsa indikatorit i mbajtësit ISMOD pluskon dhe më pas kalon në gjendje të fikur.
3. Kur të keni përfunduar me përdorimin kthejeni mbajtësin ISMOD të karikuesit që të ngarkohet në mënyrë që të përdoret sërish herën tjetër.




## VËREJTJE

**NË GJENDJE NORMALE PUNE GJATË PËRDORIMIT KUR SASIA E AEROSOLIT ËSHTË ULUR NDJESHËM OSE SHIJA E AEROSOLIT ËSHTË ULUR, KJO DO TË THOTË SE FISHEKU I DUHANIT JO TË DJEGSHËM ËSHTË MBARUAR DHE I NJËJTI DUHET TË ZËVENDËSOHET.**

## 6. INSTRUKTIMET PËR NGARKIMIN

### Instruktivet për funksionimin e karikuesit

- 1.Rekomandohet që fillimisht të ngarkohet karikuesi që të sigurohet përdorimi normal i produktit.



2. Kur të jeni gati për të ngarkuar karikuesin, lidhni kabllo e karikimit me karikuesin USB Proton dhe futeni pjesën tjetër në rrjet.

3. Gjatë karikimit, treguesi i karikimit do të pulsojë disa herë derisa treguesi të bëhet i qëndrueshëm, duke treguar që karikimi ka përfunduar.

#### Udhëzues për karikimin e mbajtësit ISMOD

1. Përpara se të filloni të karikoni mbajtësin ISMOD duhet të shihni nëse karikuesi i ngarkimit është ndezur dhe nëse ka ngarkim të mjaftueshëm.

2. Pas përfundimit të konsumimit mbajtësi ISMOD duhet të karikohet sërish që ta përdorni.


3. Gjatë karikimit duhet të lidhni interfejsin e karikimit të mbajtësit ISMOD me karikuesin. Funkcioni magnetik i produktit automatikisht do të ndizet dhe do të karikohet.

4. Indikatorit adekuat për karikimin e cigares do të pulsojë kur do të karikohet, pulsimi i kuq tregon se karikimi është në proces, ndërsa drita blu tregon se karikimi ka përfunduar.

5. Sapo mbajtësi ISMOD është karikuar krejtësisht, indikatorit do të fiket automatikisht.

## 7. PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA


Vetë produkti është i shoqëruar me komplet pastrimi dhe mirëmbajtje të mbajtësit ISMOD dhe kapakut të sipërm mbrojtës.




1. Kur pastroni mbajtësin ISMOD hiqeni kapakun e sipërm mbrojtës të mbajtësit ISMOD futeni furçën e pastrimit dhe sipas figurës në vijim rrotullojeni disa herë e më pas largojini mbetjet tek furça, përdorini shkopinjtë e pastrimit dhe në fund merruni me pllakën për pastrim.
2. Që të mos lejoni bllokimin e vrimave të kapakut mbrojtës përdorni pllakën e pastrimit dhe shkopinjtë e pambukut.

### Si ta përdorni shkopin e pastrimit?

1. Nxirrni një shkop nga shkopinjtë



2. Hapeni paketimin dhe nxirrni një shkop për pastrim.



## 8. KUJDES

1. Produkti nuk është i dedikuar për adoleshentë dhe njerëz të dobët fizikisht dhe psikikisht ose nuk janë të vetëdijshëm për përdorimin e sigurt të tij, ju lutemi të kini kujdes (Rrezik aksidenti)
2. Mos e përdorni produktin nëse kapaku mbrojtës është i hequr, që të mos digjeni nga pjesët e ngrohjes (Rrezik aksidenti)
3. Mos e përdorni pajisjen për asgjë tjetër, përveç asaj që jepet në manualin e përdorimit (Rrezik aksidenti)
4. Mos e zhysni aparaturën ose cilëndo pjesë të tij në ujë (Rrezik avarie, ky produkt nuk është rezistent ndaj ujit)
5. Mos përdorni asnjë aparaturë tjetër karikimi që nuk është në pajtim me standardet (Rrezik aksidenti)
6. Mos e karikoni pajisjen nëse nuhatni aromë të pakëndshme ose tym dhe menjëherë kontaktoni dhënësin e shërbimit (Rrezik aksidenti)
7. Nëse pa dashje bateria rrjedh, evitoni kontaktin e lëngut të rrjedhur me lëkurën ose sytë. Ju lutemi që të laheni menjëherë me ujë dhe të kërkoni ndihmën e mjekut. (Rrezik aksidenti)



## 9. PROBLEMET E ZAKONSHME DHE ZGJIDHJA E TYRE

Nuk ndizet karikuesi i ngarkimit	Kontrolloni nëse ka mjaftueshëm energji tek karikuesi	Karikojeni karikuesin e ngarkimit derisa të ketë mjaftueshëm energji
	Kontrolloni nëse karikuesi nuk është ngarkuar për një kohë më të gjatë	Bateria është e zbrazur, karikojeni menjëherë karikuesin e ngarkimit
	Kontrolloni nëse ka ndonjë problem me butonin	Dërgojeni pajisjen në qendrën lokale të shërbimit
	Kontrolloni nëse ka ndonjë problem me indikatorin	Dërgojeni pajisjen në qendrën lokale të shërbimit
Karikuesi nuk ngarkon	Nuk mund të karikohet karikuesi i ngarkimit	Dërgojeni pajisjen në qendrën lokale të shërbimit
Mbajtësi ISMOD nuk ngarkohet	Kontrolloni nëse mbajtësi ISMOD karikon	Asnjëherë mos i ngarkoni njëkohësisht mbajtësin ISMOD dhe karikuesin
	Kontrolloni nëse porta e karikimit është e dëmtuar	Dërgojeni pajisjen në qendrën lokale të shërbimit
Indikatori pulson shumë	Kontrolloni nëse pulson drita e kuqe kur shtypet butoni dhe fiket kur është e lirë	Bateria është e zbrazur, karikojeni menjëherë pajisjen
	Fikeni pajisjen që të mos mbingrohet	Prisni deri 3-5 minuta derisa temperatura e pajisjes të stabilizohet
	Shihni nëse ka ndonjë problem me ngrohësin	Dërgojeni pajisjen në qendrën lokale të shërbimit

## 10. EVITIMI I PËRGJEGJËSISË

Ju lutemi të ndiqni udhëzimet e masave të sigurisë, sepse janë të një rëndësie esenciale

1. ISMOD II Plus ngarkohet me bateri. Duhet të ngarkohet kur bateria është e zbratur. Mos e lini ISMOD Indego në afërsi të temperaturave të larta ose ngrohësve që të shmangni dëmtimin e baterisë.
2. Lexoni me kujdes të gjitha udhëzimet përpara se të përdorni ISMOD II Plus. Mbajeni manualin e përdorimit për referencë në të ardhmen. Kur përdorni ISMOD II Plus ndiqni udhëzimet e prodhuesit për të shmangur dëmtimet e mundshme. Paralajmërimet dhe udhëzimet e sigurisë në këtë manual përdorimi mund të mos mbulojnë të gjitha mundësitë dhe situatat që mund të lindin. Kini kujdes kur përdorni ose mirëmbani produktin personal elektronik.
3. Përdorni vetëm fishek ekskluziv të duhanit të padjegshëm.
4. ISMOD Indego përmban bateri litiumi, për largimin e tyre ju lutemi që të ndiqni kërkesat e vetëqeverisjes lokale.

### **BATERI LITIUMI**

1. Nëse produkti ruhet për një kohë të gjatë në një temperaturë të lartë, bateria e litiumit do të shpërbëhet.
2. Bateria do të shkarkohet kur ruhet për një kohë të gjatë pa punuar. Karikoni pajisjen përpara se ta përdorni.
3. Kur nuk e përdorni pajisjen për një kohë të gjatë, shmangni ruajtjen e saj në gjendje të ngarkuar plotësisht ose në kushte të temperaturës/lagështisë së lartë për të shmangur dështimin e përshpejtuar të baterisë.